



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

NR. 18 REGJ.

DT. 11.05.2023 REGJ.

NR. 18 VENDIMI

DT. 12.05.2023 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Edlira PETRI	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Blerona HASA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Emona MUÇI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Alma KOLGJOKA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtar:	Sokol IBI	<i>(Anëtar)</i>

asistuar nga sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, më datë 12.05.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen nr. 18 Regjistri Themeltar, datë 11.05.2023 që i përket:

PADITËS:

Subjekti Zgjedhor Partia e Lirisë, i përfaqësuar nga Av. Altin Kaziaj, i pajisur me autorizim nr. 146/1 prot., datë 11.05.2023.

I PADITUR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i përfaqësuar nga Znj. Pavlina Doçaj dhe Z. Erdal Mema, të pajisur me autorizim nr. 5002 prot., datë 11.05.2023.

PERSON I INTERESUAR:

Subjekti Zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, përfaqësuar nga Z. Shkëlqim Sulo dhe Z. Klardi Xhemali, pajisur me autorizim nr. 390 prot., datë 08.05.2023.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr. 90, datë 10.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
Caktimin e Partisë së Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 9, 45, 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë; nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të gjykimit të çështjes palët pjesëmarrëse në proces kërkuan : - **Pala paditëse**, subjekti zgjedhor Partia e Lirisë : Pranimin e padisë sipas objektit; - **Pala e paditur**, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve : Rrëzimin e padisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 90, datë 11.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve; - **Personi i interesuar**, subjekti zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet: Rrëzimin e padisë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi dëgjoji palët, mori në shqyrtim provat e paraqitura, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Mbi këtë bazë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në vijim referuar si KQZ) ka organizuar procesin zgjedhor, konform rregullave që dikton Kodi Zgjedhor. Në fazën e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, u regjistruan si të tillë edhe Partia e Lirisë (PL), Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, si dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Ky i fundit, sipas vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) pranoi pjesëmarrjen në koalicion të Partisë së Lirisë (PL), Partisë Demokristiane të Shqipërisë (PDK) dhe Partisë së Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).

2. Në vijim, pas regjistrimit edhe të listave të kandidatëve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, KSHZ në zbatim të nenit 95, paragrafi 2, nenit 96 pika 2, si dhe 183, pika 8 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ka marrë vendimin për caktimin e partive politike, që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 404 datë 24.04.2023, pasi dëgjoji përfaqësuesit e partive politike në KQZ, vendosi:

"1.Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave është Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Partitë politike të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në bazë të rezultatit të shortit, janë:

a) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet,

b) Partia e Lirisë.

3. Shorti zhvillohet me datë 24.4.2023 ora 12:00.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij".

3. Kundër vendimit të mësipërm të KSHZ-së, subjekti zgjedhor "Partia e Lirisë" paraqiti ankimin nr. 53, datë 27.04.2023 në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe "ndryshimin e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023". Me pretendimin se Partia e Lirisë ishte e vetmja parti politike që kishte të drejtën e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, parashtrroi këto argumente :

- Vendimmarrja e Komisionerit ka cenuar barazinë në garë midis palëve, pasi ka barazuar në peshë dy parti të ndryshme, si në pikëpamjen elektorale ashtu dhe në atë politike.
- Në zgjedhjet e vitit 2017, nga ku bazohet dhe caktimi i anëtarëve të GNV-ve, "Partia e Lirisë" ka marrë 19 mandate deputetësh, ndërsa "Partia Drejtësi Integritet dhe Unitet" ka marrë vetëm 3 të tilla. Vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor ndër vite ka sanksionuar faktin se shpërndarja e anëtarëve të administratës zgjedhore duhet bërë sipas aktualitetit politik mazhorancë minorancë.

- Subjekti zgjedhor PDIU garon vetëm në një bashki të vendit me kandidat për kryetar bashkie, ndërsa “Partia e Lirisë” kandidon në 61 bashkitë e vendit, duke krijuar mospërputhje haptazi me interesin e ligjshëm të numërimit dhe mbrojtjes të votave. Nga deklaratimet e bëra menjëherë pas konstituimit të Kuvendit në vitin 2017, dy deputetë të PDIU-së janë deklaruar si deputetë të pavarur.

3.1 Në procesin për shqyrtimin e këtij ankimi, rezultoi të ketë marrë pjesë si subjekt i interesuar edhe subjekti zgjedhor Partia politike “Partia Drejtësi, Integritet dhe Unitet”, përfaqësuesi i së cilës kërkoi të lihej në fuqi vendimi i KSHZ-së.

4. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve e mori në shqyrtim këtë ankim në datë 02.05.2023, në një mbledhje plenare ku morën pjesë katër nga pesë anëtarët e KAS. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendim nr. 71, datë 02.05.2023, referuar faktit se anëtarët e këtij organi votuan me dy vota pro ankimit dhe dy vota kundër ankimit, kërkesa ankimore objekt i këtij procedimi nuk u konsiderua e pranuar, pasi pro pranimit të saj duhet të votojnë së paku tre anëtarë. Në këto kushte KAS vendosi : *“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 53, datë 27.04.2023 të depozituar nga “Partia e Lirisë”, për shkak të mungesës së numrit të kërkuar të anëtarëve për vendimmarrje. 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve...”*

5. Subjekti zgjedhor Partia e Lirisë, duke mos u dakordësuar me vendimin e KAS, si dhe duke pretenduar paligjshmërinë e tij, i'u drejtua Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

6. Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, duke konstatuar mos marrjen e vendimit për shqyrtimin e ankimit administrativ, konform detyrimit ligjor, konstatoi pavlefshmërinë absolute të vendimit të mësipërm të KAS dhe në bazë të neneve 145.2 dhe 158.4 të Kodit Zgjedhor, urdhëroi KAS-in të marrë vendim përfundimtar lidhur me ankimin e subjektit zgjedhor Partia e Lirisë (shih vendimin nr. 17, datë 09.05.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor).

7. Në zbatim të vendimit nr. 17, datë 09.05.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, në datë 10.05.2023 KAS-i zhvilloi mbledhjen për rishqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 53, me përbërje të plotë të trupës. Ankuesi parashtrori të njëjtat pretendime, ndërsa kërkoi edhe përjashtimin e një prej anëtarëve të KAS, me argumentin se kishte konflikt interesi. Konkretisht, sipas ankuesit, Z. Ilir Rusmajli, anëtar i KAS-it, ka kandiduar për pozicionin e Avokatit të Popullit, çka përbën një fakt për të cilin ai nuk duhej të merrte pjesë në shqyrtimin e ankimit. Kjo kërkesë është refuzuar nga KAS me vendim të ndërmjetëm.

7.1 Në procesin për rishqyrtimin e këtij ankimi, rezulton të ketë marrë pjesë sërish si subjekt i interesuar subjekti zgjedhor Partia politike “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfaqësuesi i së cilës kërkoi të lihej në fuqi vendimi i KSHZ-së nr. 404, datë 24.04.2023, pasi kjo parti është pjesë e opozitës parlamentare, si dhe ka plotësuar numrin minimal të mandateve.

8. Në dobi të shqyrtimit administrativ, KAS-i mori në shqyrtim edhe aktet në vijim : - Vendim i shkurtuar i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nr. 17, datë 09.05.2023; - Shkresën nr. 3957/1 prot., datë 20.04.2023 i Kuvendit të Shqipërisë; - Deklaratat në Kuvend të dy deputetëve që nuk janë pjesë e grupeve parlamentare; - Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 555, datë 26.07.2017 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017”; - Programi Qeverisës 2017-2021; - Vendimi nr. 84/2017 i Kuvendit “Për miratimin e përbërjes dhe program politik të Këshillit të Ministrave”; - Relacion për projektvendimin e KSHZ “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”; - Vendimi nr. 8, datë 19.04.2021 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor Tiranë; - Procesverbalet e Kuvendit, datë 09.09.2017; 11.09.2017; 12.09.2017 dhe 14.09.2017.

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendim nr. 90, datë 10.05.2023, vendosi: *“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 53, datë 27.04.2023 të depozituar nga “Partia e Lirisë. 2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”. ...”.*

9.1 Sipas vendimit të mësipërm, KAS arsyeton se :

- *KAS-i konstaton se emërimi i anëtarëve të GNV-ve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 rregullohet nga dispozita tranzitore e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë ka hyrë në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (d.m.th. në datën 19.08.2020) dhe aktualisht është e vlefshme vetëm për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.*

- *Dispozita e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor përcakton se “në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”.*

- Me këtë formulim ligjvënësi jo vetëm ka limituar zbatimin e këtij rregullimi tranzitor, por edhe ka “ngrirë” në kohë kriterin përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Ky kriter do të bazohet në hulumtimin e konfigurimit shumicë-pakicë në çeljen e Kuvendit, menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017. Çelja e Kuvendit ka lidhje me seancën inauguruese të tij, e cila është zhvilluar në datën 9 shtator 2017, si dhe me seancat konstitutive të tij, të cilat janë zhvilluar në datat 9, 11, 12 dhe 14 shtator 2017, kur Kuvendi verifikoi mandatet e deputetëve, realizoi betimin e tyre, zgjodhi Kryetarin e Kuvendit, miratoi programin dhe përbërjen e qeverisë, bëri ndarjen e deputetëve në komisione dhe delegacione, si dhe zgjodhi organet e tjera të brendshme drejtuese.

- Neni 96 i Kodit Zgjedhor përcakton, se të drejtën e propozimit për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-së mund ta kenë vetëm partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare, të cilat janë të regjistruara në zgjedhje dhe që rezultojnë se kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë (për shkak të dispozitës tranzitore të pikës 8 të nenit 183, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017).

- Gjithashtu pika 1 e nenit 96 të Kodit Zgjedhor përcakton se kur për vendin e tretë ose të katërt në GNV konkurrojnë dy ose më shumë parti, atëherë përcaktimi i partisë që gëzon të drejtën e propozimit për anëtarin respektiv të GNV-së bëhet nëpërmjet hedhjes së shortit midis partive konkurruese. Shorti hidhet për çdo ZAZ.

- Mbështetur në kushtet dhe kriteret e shtjelluara më sipër, Komisioneri ka identifikuar qartë listën e partive parlamentare që plotësojnë kriterin e numrit minimal të mandateve. Ato janë:

- Partia Socialiste e Shqipërisë me 74 mandate
- Partia Demokratike me 43 mandate
- Lëvizja Socialiste për Integrim me 19 mandate
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet me 3 mandate.

Të katër partitë e sipërcituara janë parti të regjistruara dhe që marrin pjesë në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

- Dispozita e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor është dispozitë tranzitore dhe kriteret që kjo dispozitë ka vendosur për kompozimin e GNV-ve janë caktuar të gjitha post factum. Kjo do të thotë, se në momentin e miratimit të ligjit legjislatori e ka pasur të qartë se cilat ishin partitë që kishin të drejtën e propozimit për anëtarët e GNV-ve dhe se legjislatori ka dashur pikërisht që PS, PD, LSI dhe PDIU të propozonin anëtarët e GNV-ve. Legjislatori ka vendosur me vullnet sovran dhe me qartësi ligjore. Kërkesa ankimore ka qëllim që të modifikojë këtë vullnet sovran dhe të zbehë këtë qartësi ligjore. Vullneti i ligjit nuk modifikohet dot me procedurë administrative.

- Dispozita e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor ka qenë e vlefshme përzgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023. Kriteri për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017” është zbatuar në të dy rastet njëjloj nga Komisioneri, me vendimin nr.193, datë 31.03.2021 dhe me vendimin nr. 404, datë 24.04.2023. Në zgjedhjet e vitit 2021 PDIU e humbi të drejtën e propozimit jo me arsyetimin se nuk plotësonte kriterin, por me arsyetimin se pjesëmarrja në koalicion zgjedhor ia suprimonte këtë të drejtë. Nëse në zgjedhjet e vitit 2021 PDIU plotësonte kriterin për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017”, atëherë ajo e plotëson atë edhe në zgjedhjet e vitit 2023.

- Ankuesi ngriti pretendimin, se PDIU nuk plotëson kriterin për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017”, sepse ka humbur dy mandate në fillim të legjislaturës, për shkak se dy deputetë të zgjedhur nga radhët e palës së interesuar janë deklaruar “deputetë të pavarur”. Deklarimi “i pavarur” nuk i heq subjektit zgjedhor mandatin e fituar nga zgjedhjet, që kërkon pika 8 e nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Deklarimi bëhet për efekt të formimit të grupeve parlamentare dhe ka lidhje me procedurat konsultive të Kuvendit, por jo me rezultatit e zgjedhjeve, i cili është i pandryshueshëm. Rezultati i zgjedhjeve nuk provohet nga dokumentacioni parlamentar, por provohet nga vendimi i KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2017. Vendimi i KQZ-së nr. 555, datë 26.07.2017 ka shpallur se PDIU ka fituar një mandat në zonën zgjedhore qarku Dibër dhe dy mandate në zonën zgjedhore qarku Elbasan.

- Komisioneri ka konkluduar përgjatë procedurës për miratimin e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 se konfigurimi shumicë-pakicë i zgjedhjeve të vitit 2017 ndante në anën e shumicës Partinë Socialiste dhe në anën e opozitës Partinë Demokratike, Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Komisioneri hetoi nëse sjellja parlamentare (historiku i votimit) i çonte subjektet drejt kualifikimit si pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, por doli në konkluzionin se “nuk ka asnjë mekanizëm dhe kriter ligjor për të përcaktuar partinë politike të shumicës dhe të pakicës parlamentare duke ju referuar qëndrimeve në Kuvend të deputetëve të një force politike”.

- KAS-i çmon se përkufizimi doktrinal i shumicës parlamentare i referohet partisë ose koalicionit të partive parlamentare që formojnë bashkërisht qeverinë e re pas zgjedhjeve (ndryshe shumica qeverisëse) dhe që e mbajnë në jetë atë. Në fillimin e legjislaturës pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, Partia Socialiste formoi e vetme qeverinë. Në fillimin e legjislaturës, Partia Socialiste nuk lidhi asnjë marrëveshje koalicioni me asnjërën nga partitë e tjera parlamentare. Koalicioni qeverisës me partinë Lëvizja Socialiste për Integrim i legjislaturës pararendëse nuk u rikonfirmua. Partia Socialiste u fut në zgjedhjet e vitit 2017 me

kërkesën drejtuar elektoratit që t'a mbështeste me votë për një qeverisje si forcë e vetme, pa koalicion. Rezultati i zgjedhjeve ia krijoi këtë mundësi.

- Në preambulën e programin e qeverisë, i cili iu prezantua Kuvendit në çelje të legjislaturës, në datën 11.09.2017, ndër të tjera, lexohet “pa dyshim që është privilegj për ne, por është sidomos një sfidë shumë e madhe ky mandat i plotë për të qeverisur të vetëm”. Përbërja e Këshillit të Ministrave, e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 84/2017 “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, përfshin vetëm eksponentë të Partisë Socialiste. Këto dy dokumente janë prova të faktit juridik, se në çeljen e legjislaturës shumica parlamentare përbëhej vetëm nga Partia Socialiste. Për këtë arsye, gjendet i drejtë dhe i mbështetur konkluzioni i Komisionerit për ndarjen që ka bërë për konfigurimin shumicë pakicë në çeljen e legjislaturës.

- Votimi ose jo i ligjeve të veçanta nuk është kriter për përcaktimin e shumicës apo pakicës parlamentare. Praktika parlamentare njihet pa fund raste të miratimit të ligjeve me më pak vota se sa përfshin shumica parlamentare, sikurse njihet dhe mjaft raste të miratimit të ligjeve me shumicë më të lartë, deri me unanimitetin e gjithë deputetëve të Kuvendit. Për më tepër, ai nuk është i zbatueshëm në rastin e pikës 8 të nenit 183, sepse kjo pikë kërkon fotografimin e konfigurimit shumicë-pakicë vetëm në momentin e çeljes së legjislaturës së dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

- Gjithashtu nuk formon kriter performanca politike përgjatë legjislaturës. Spektri politik parlamentar përbëhet nga një shumicë partish, secila me identitetin e vet dhe me platformat e veta politike. Ky identitet dhe këto platforma e vendosin një parti politike në një pozicion të caktuar të spektrit politik. Përkatësia opozitare nuk varet nga fakti nëse një parti e opozitës identifikohet si opozitë ekstreme, si opozitë reale, si opozitë tradicionale, si opozitë ideologjike, si opozitë e moderuar, si opozitë konstruktive, si opozitë luajale, apo si opozitë fiktive. Përkatësia tek shumica parlamentare nuk varet nga fakti se një parti identifikohet si aleat besnik, si aleat tradicional, si aleat sezonal, si aleat pragmatist, i qëndrueshëm/i paqëndrueshëm etj. Të gjitha këto janë kategori mendimi dhe shprehjeje të natyrës politike, por nuk zbulojnë as lidhin pas vetes kategori të natyrës juridike. Përkatësia si pjesë e koalicionit qeverisës del nga ekzistenca e marrëveshjeve të koalicionit qeverisës dhe anasjelltas, përkatësia si pjesë e pakicës parlamentare del nga mungesa e marrëveshjeve për koalicion qeverisës. - Në rastin objekt shqyrtimi këto marrëveshje mungojnë. Për më tepër, performanca politike përgjatë legjislaturës është irrelevante në rastin e pikës 8 të nenit 183, sepse kjo pikë kërkon fotografimin e konfigurimit shumicë-pakicë vetëm në momentin e çeljes së legjislaturës së dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

- Në relacionin shoqërues të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 konstatohet se “nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia e Lirisë (Partia Lëvizja Socialiste për Integrim) dhe Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet” përmbushin kriterin e numrit të mandateve dhe u lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Rrjedhimisht anëtari i katërt do të përcaktohet në bazë të rezultatit të shortit për çdo ZAZ, ndërmjet Partisë së Lirisë dhe Partisë “Drejtësi Integrim dhe Unitet”.

- Ankuesi ka pretenduar me kërkesën e vet ankimore se “vendimmarrja e Komisionerit është diskriminuose dhe shkelet barazia në garë, kjo në kuadër të vetë frymës së kodit elektoral nenet e të cilit dhe ratio duhet të sigurojnë barazpeshimin politik në pjesëmarrje në çdo nivel”.

Referencat në “frymë” apo në “ratio legis” që injorojnë gërmën e ligjit janë të pathemelta. Analiza e “frymës” së ligjit ka kuptim vetëm nëse ajo vihet në përdorim për të qartësuar apo saktësuar kuptimin e gërmës së ligjit, jo për të anashkaluar ligjin, aq më keq për t’a shkelur atë. Në rastin e dispozitës së pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor, gërma e ligjit është shumë e qartë dhe nuk ka nevojë të bëhen përsiatje rreth “frymës” për të kuptuar dhe zbatuar dispozitën.

- Kompozimi i strukturave të administratës zgjedhore në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë nuk bëhet në bazë të parimit të përfaqësimit politik, por në bazë të parimit të besueshmërisë politike dhe të transparencës. Palët politike kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të trupës zgjedhore, por anëtarët, nga momenti i emërimit, nuk janë përfaqësues politikë, por janë pjesë e një strukture administrimi të centralizuar dhe që i nënshtrohet vetëm ligjit. Administrimi i zgjedhjeve nuk është komponent i garës, prandaj është nonsens juridik të pretendosh “barazi gare” tek përbërja e trupës që administron zgjedhjet.

- Ankuesi e sheh administratorin zgjedhor si të lidhur me subjektin zgjedhor propozues. Sipas tij, administratori zgjedhor i përket, përfaqëson dhe mbron interesat e subjektit propozues përgjatë administrimit të procesit. Ky këndvështrim është i pambështetur në ligji. Ligji i ka njohur subjekteve zgjedhore të drejtën e caktimit të vëzhgueseve në proces. Vetëm këta i përkasin, përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e subjektit propozues përgjatë administrimit të procesit. Administratorët zgjedhorë janë të punësuar me kohë të pjesshme të KQZ-së. Ata shpërblehen nga KQZ-ja për punën që kryejnë. Detyra e tyre është administrimi i procesit në dobi të ligjit, gjë që do të thotë, në dobi të të gjithë subjekteve pjesëmarrëse në garë, të atyre që kanë të drejtën e propozimit, por edhe të atyre që nuk e disponojnë këtë të drejtë. Perceptimi i administratorëve zgjedhorë si “përfaqësues” dhe “mbrojtës” të interesave vetëm të subjektit propozues është i kundraligjshëm dhe i kundërvihet drejtpërdrejt parimit të barazisë së armëve në garë, që evokon në kërkesën ankimore ankuesi.

- Kodi Zgjedhor nuk ka vendosur kritere barazie, as strikte, as proporcionale, në të drejtën e dy subjekteve konkurruese për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Kodi ia ka besuar rezultatin shortit të hedhur midis këtyre dy subjekteve për çdo ZAZ. Kriteri që ka vendosur Kodi Zgjedhor është rastësor dhe i tillë duhet të mbetet. Pretendimi i ankuesit se ai duhet të marrë gjithçka, ose së paku proporcionalisht më shumë se subjekti konkurrues është i pambështetur në ligj.

- Ankuesi pretendon se “vendimmarrja objekt ankimi vjen në kundërshtim flagrant me qëndrimin dhe jurisprudencën konstante të Kolegjit Zgjedhor për të tilla çështje, që pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor në dispozitat relevante që cekin aspektet e GNV”. Citimet në kërkesën ankimore janë pa referenca (përfshirë vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 10, datë 06.06.2019). Lidhur me këtë pretendim, KAS konstaton se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (ndryshimet e fundit), Kolegji Zgjedhor ka marrë vetëm një vendim që ka për objekt përbërjen e GNV-ve, vendimin nr. 8, datë 19.04.2021, por asnjë vendim që ka për objekt zbatimin e dispozitës së pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Kjo do të thotë se kërkesa ankimore nuk mbështetet dot për arsyetimin e pretendimeve të veta, sikurse pretendon, në “jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor”.

- Ankuesi pretendon se “nuk bën sens dhe as gjen mbështetje në ligj apo praktikë, që t’i jepet anëtari i numërimit në GNV një apo disa subjekteve që nuk garojnë në të gjithë vendin”. Këto zgjedhje janë po aq zgjedhje për kandidatët për kryetar bashkie, sa ç’janë zgjedhje për këshillat bashkiake. Identifikimi i tyre vetëm me zgjedhjet për kandidatët për kryetar bashkie nuk është i mbështetur në ligj. Për më tepër, në këto zgjedhje Partia Demokratike që ka të drejtën prioritare të propozimit për të gjithë strukturën e administrimit të zgjedhjeve në të gjithë Shqipërinë nuk ka regjistruar kandidatë për kryetar bashkie në shumicën e bashkive. Administratorët zgjedhorë të propozuar prej saj janë në ushtrim të detyrës në të gjithë territorin.

- Neni 96 i Kodit Zgjedhor nuk ka kriter për të drejtën e propozimit të anëtarëve të GNV-së konkurrimin me kandidatë për kryetar bashkie në të gjitha bashkitë, por ka kriter regjistrimin si subjekt në zgjedhje. Këtë kriter e plotëson si ankuesi, ashtu dhe pala e interesuar.

- Detyrimi i Komisionerit në marrjen e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 ka qenë që të respektojë rigorozisht kushtet dhe kriteret e neneve 96 dhe 183 të Kodit Zgjedhor, jo të balancojë pretendimet e palëve konkurruese. Komisioneri e ka respektuar rigorozisht detyrimin e tij ligjor.

PROCEDURA GJYQËSORE

10. Subjekti zgjedhor Partia e Lirisë, duke mos u dakordësuar me vendimin e KAS, si dhe duke pretenduar paligjshmërinë e tij dhe të vendimit të KSHZ-së, ngriti para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padinë objekt gjykimi.

10.1 Me vendim të ndërmjetëm, Kolegji Zgjedhor lejoi pjesëmarrjen në gjykim si person i interesuar subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, që kish marrë pjesë edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në KAS për shqyrtimin e ankimit administrativ, konform nenit 133, paragrafi 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor.

PRETENDIMET E PALËS PADITËSE DHE PRAPËSIMET E TË PADITURIT

11. Subjekti zgjedhor Partia e Lirisë, duke mos u dakordësuar me vendimin e KAS, si dhe duke pretenduar paligjshmërinë e tij dhe të vendimit të KSHZ-së, ngriti para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padinë objekt gjykimi duke parashtruar këto pretendime :

11.1 Dy anëtarët e KAS, që kanë votuar pro ankimit, trajtojnë argumente të fortë interpretues së frymës së ligjit, të cilët vijnë si pasojë e aplikimit të drejtë të ligjit dhe jo si pasojë e interesave mesquine apo patronazhizmit dhe aktivizmit partiak, ashtu si kanë vepruar në argumentet e pa ligjëruara dhe të pa mbështetura anëtarët që kanë votuar kundër ankimit, duke u vënë dukshëm në shërbim të një politike, e cila pa asnjë bazë ligjore, përdor funksionarë të lartë duke i joshur me poste publike apo privilegje të pamerituara.

11.2 Tre anëtarët nuk japin asnjë argument të karakterit ligjor në frymë të vetë ligjit elektoral, të dakordësisë së aktorëve politikë, të baraspeshimit, të konceptit të pjesëmarrjes në zgjedhje në çdo nivel, të barazisë së armëve, të garancisë kushtetuese të një procesi shumë të rëndësishëm, të legjitimitetit dhe interesit të ligjshëm, apo të çdo koncepti tjetër që vjen në frymën e garancisë të një procesi demokratik votimi.

11.3 PDIU, nuk ka arritur të propozojë kandidatë për kryetar bashkie në 61 bashkitë e vendit. Subjekti PD garon zyrtarisht në 12 bashki me kandidatë për kryetar bashkie, ndërkohë që subjekti PDIU garon vetëm në 1 bashki, nga 61 bashkitë e vendit për kryetar bashkie. Në këtë rast shtrohet pyetje, votat e kujt do të numërojnë apo mbrojnë këta anëtarë? Cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit për të garantuar pjesëmarrje të partive të parashikuara në kod në çdo nivel zgjedhor, përfshirë këtu dhe fazën përfundimtare të procesit elektoral në GNV? Pse nuk është garantuar koncepti i baraspeshimit politik në pjesëmarrje në zgjedhje? Pse nuk janë siguruar kushtet kumulative në kuadër të interesit të ligjshëm, që kanë të bëjnë me parashikimet e ligjvënësit në sigurimin e dy ose më shumë mandateve për të lindur e drejta e propozimit të anëtarit të GNV-

së dhe fakti që pavarësisht se kjo e drejtë mund t'i lindë (nëse mund të sigurojë këto mandate të deklaruara nga vetë të zgjedhurit) duhet që pjesëmarrja e pretenduesit në garë të jetë në totalin e garës dhe jo vetëm në 1 nga 61 bashkitë garuese?

11.4 KSHZ dhe KAS, në respektim të frymës jurisprudenciale tashmë të konsoliduar të Kolegjit, do të duhet të interpretonte në mënyrë të qartë, duke bërë një analizë faktike pa lënë mangët asnjë element vlerësues, duke konkluduar kështu në frymë dhe në germë sipas parimeve tashmë të konsoliduara të vendimmarrjeve më të larta, si dhe të vetë dakordësisë politike nëpërmjet ndryshimeve të ligjit zgjedhor në vitin 2020.

11.5 Me Vendimin nr. 10, datë 06.06.2019, Kolegji shprehet se në çdo rast duhet interesi i ligjshëm duke mbuluar kështu me pjesëmarrje dhe regjistrim të gjitha nivelet e përfaqësimit në KQZ, thënë ndryshe, duke filluar kështu që nga paraqitja e kandidaturave për kandidatët për kryetar bashkie, për 61 Bashki, apo dhe mbulimin e 61 bashkive me kandidatë për këshillat bashkiak duke saktësuar se, ligjvënësi kur i ka njohur të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor subjekteve zgjedhore, është bazuar në logjikën ligjore se partitë kryesore parlamentare do të përmbushin misionin, për të cilin janë krijuar, në mënyrat dhe mjetet e parashikuara në ligj për përmbushjen e këtij misioni, pra nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje. Kolegji përcakton pjesëmarrjen në zgjedhje/garë, si element thelbësor i pasjes së legjitimitetit për t'u bërë pjesë e atyre që mund të quhen "privilegjet" e ligjit, apo të drejtat që një subjekt politik mund të përfitojë sipas parashikimeve ligjore, gjithmonë duke siguruar pjesëmarrjen në garë.

11.6 Në këtë kuadër është e domosdoshme, të merret përgjigje lidhur me: 1. Nëse në situatën hipotetike, juridikisht/ligjërisht, një subjekt përfitues si në rastin konkret nuk merr pjesë në zgjedhje, a do të quhej sërish i ngurtë ligji? Nëse një subjekt nuk do të ekzistonte në zgjedhjet e ardhshme dhe përfitimet, do t'i vinin sipas parashikimeve të nenit 183/8 të K.Z, a do quhej sërish i ngurtë ligji? Për këto arsye, këto veprime arbitrare të KAS duhet të marrin fund dhe Kolegji Zgjedhor duhet të vendosë kufij të qartë, lidhur me interpretimin e saktë të dispozitës së nenit 183/8 të Kodit Zgjedhor.

12. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, kërkoi rrëzimin e padisë. Qëndrimi i KQZ-së u mbështet në argumentet e KAS, mbi të cilat u mor vendimi objekt padie.

13. Subjekti zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet kërkoi gjithashtu rrëzimin e padisë.

14. Lidhur zgjidhjen e çështjes, Kolegji, pasi analizoi faktet që qëndrojnë në themel të mosmarrëveshjes, si dhe pretendimet e ngritura, duke i vlerësuar ato në raport me dispozitat ligjore, vuri në diskutim nëse procesi zgjedhor dhe konkretisht rregullat për caktimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave, janë cenuar apo jo nga ushtrimi i pushtetit të KSHZ-së nëpërmjet vendimit “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

DISPOZITAT E ZBATUESHME TË KODIT ZGJEDHOR

Neni 3 “Parime të përgjithshme” : “... 2. *Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. ...*”

Neni 95 “Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)”: “... 2. *Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi. ...*”

Neni 96 “Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve” : “ 1. *Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare. ...*”.

Neni 183 “Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe i administratës zgjedhore” (dispozitë kalimtare e ligjit 101/2020): “... 8. *Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.*”

VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

15. Paraprakisht Kolegji Zgjedhor Gjyqësor evidenton se çështja që shtrohet për zgjidhje lidhet me interpretimin dhe zbatimin e normave, që rregullojnë ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave në një proces zgjedhor.

16. *Çështja e parë që u vu në diskutim nga Kolegji Zgjedhor lidhet me ligjin e zbatueshëm në rastin në shqyrtim dhe konkretisht u diskutua nëse, dispozita tranzitore e nenit 183.8 e Kodit Zgjedhor, ishte e zbatueshme apo jo për zgjedhjet vendore që do të zhvillohen në datë 14 maj 2023. Referuar formulimit të kësaj dispozite, si dhe faktit se në datë 7 mars 2022 u zhvilluan zgjedhje të pjesshme vendore (për kryetarin e bashkisë për gjashtë bashki), u vu në diskutim nëse dispozita tranzitore është zbatuar për ato zgjedhje dhe nëse po, e mund të zbatohet edhe për zgjedhjet vendore që do të zhvillohen në datë 14 maj 2023.*

16.1 Lidhur me çështjen e mësipërme, Kolegji mban në vëmendje se dispozita tranzitore e nenit 183 të Kodit Zgjedhor u miratua me ligjin nr. 101/2020 “Për disa shtetas dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Nga tërësia e normave të këtij ligji, rezulton se ligjvënësi bëri ndërhyrje të rëndësishme në ligjin bazë, përfshirë edhe mënyrën e organizimit të administratës zgjedhore në nivel qendror. KQZ tashmë do të kishte tri organe, me funksione dhe kompetenca të caktuara në po këtë kod. Nga ana tjetër, ligjvënësi nuk ndryshoi formulën e ngritjes së administratës zgjedhore në nivelin bazë të saj, përfshirë Grupet e Numërimit të Votave (GNV), që ngrihen sipas formulimit të neneve 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë, në dispozitën tranzitore të ligjit ndryshues të Kodit Zgjedhor, u përcaktua se “... 8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.”. Në këto kushte lind nevoja për të interpretuar dispozitën tranzitore, në funksion të qëllimit që pati ligjvënësi në hartimin e saj. Kështu, rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, në kohën e miratimit të ligjit, ishte i njohur për të gjithë dhe, qartazi, ligjvënësi ka synuar që ky rezultat të kushtëzojë ngritjen e organeve të administratës për dy proceset zgjedhore (ato të përgjithshme të vitit 2021 dhe ato vendore të vitit 2023), që do të zhvilloheshin në të ardhmen. Në funksion të këtij qëllimi, organizimi i zgjedhjeve të pjesshme në mars 2022, për kryetar bashkie për gjashtë bashki të vendit, nuk ezauron efektin e dispozitës tranzitore, ndaj Kolegji gjen të drejtë ligjin, mbi të cilin KSHZ dhe KAS, kanë zgjidhur çështjen e kompozimit të GNV-

ve për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 (për këtë çështje janë dakordësuar edhe vetë subjektet zgjedhore të përfshira në mosmarrëveshje).

17. Në vijim lidhur me interpretimin dhe zbatimin e 183.8 të Kodit Zgjedhor, në funksion të debatit mes palëve në proces, Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk ka shkaqe të ligjshme për të arritur në përfundimin se KSHZ dhe KAS kanë marrë vendime të paligjshme.

17.1 Paraprakisht Kolegji Zgjedhor rithekson se Kodi Zgjedhor vijoi të rregullojë në mënyrë të njëjtë procedurën e ngritjes së organeve të ulëta zgjedhore (KZAZ dhe GNV), me gjithë ndryshimet e bëra me ligjin nr. 101/2020. Kështu, si edhe më parë, këto organe do të ngriheshin bazuar në përfaqësimin politik të partive në Kuvend, sipas konfigurimit shumicë qeverisëse dhe pakicë parlamentare (shih nenet 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor). Sigurisht që në themel të së drejtës për të propozuar anëtarë të organeve zgjedhore, qëndron së pari suksesi i partive politike në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Në këtë mënyrë, krahas partive të para të shumicës dhe pakicës parlamentare, ligjvënësi përfshiu në përbërje të organeve zgjedhore edhe partitë e tjera parlamentare të shumicës dhe pakicës, që kishin një rezultat zgjedhor së paku me dy deputetë fitues. Ky rezultat zgjedhor që përkethehet në mbështetje nga zgjedhësit, ngarkon partinë politike me të drejtën dhe përgjegjësinë publike për të marrë pjesë edhe në administrimin e zgjedhjeve të ardhshme. Ndërkohë, mënyra e formulimit të dispozitave zgjedhore dhe referenca në parti të shumicës qeverisëse dhe pakicës parlamentare, lë vend për të diskutuar nëse partitë përkatëse do të përcaktohen sipas situatës politike në momentin e ngritjes së organeve zgjedhore. Me fjalë të tjera, duket sikur ligjvënësi i referohet jo thjesht rezultatit të zgjedhjeve pararendëse, por edhe zhvillimeve të mëtejshme politike, mbi të cilat është konsoliduar si shumica qeverisëse, ashtu edhe opozita parlamentare. Kjo zgjedhje përkon me qëllimin e ligjvënësit për të garantuar një ndarje të drejtë të përgjegjësisë për administrimin e zgjedhjeve mes shumicës dhe pakicës, në kohën e zhvillimit të procesit zgjedhor.

17.2 Rregullimi i mësipërm mbeti i njëjtë edhe pas ndryshimeve të rëndësishme që i'u bënë Kodit Zgjedhor me ligjin nr. 101/2020, duke u vlerësuar në përputhje me qëllimin afatgjatë të ligjvënësit. Nga ana tjetër, me anë të dispozitës tranzitore të nenit 183.8, shumica e cilësuar e Kuvendit, rregulloi në mënyrë të posaçme ngritjen e organeve zgjedhore vetëm për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin (ato të vitit 2021) si dhe për organet e qeverisjes vendore (ato të vitit 2023). Për këto procese, Kuvendi vendosi që ngritja e KZAZ-ve dhe GNV-ve të përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Kjo do të thotë se pavarësisht formulimit të dispozitave në trungun e Kodit Zgjedhor, për dy proceset e ardhshme zgjedhore,

referenca do të bëhej në rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2017, rezultat ky i njohur tashmë. Sikurse është evidentuar edhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në rezultatin për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, partitë parlamentare që plotësojnë kriterin e numrit minimal të mandateve janë: Partia Socialiste e Shqipërisë me 74 mandate; Partia Demokratike me 43 mandate; Lëvizja Socialiste për Integrim me 19 mandate; Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet me 3 mandate. Partia Socialiste e Shqipërisë ishte partia e shumicës parlamentare, sepse formoi e vetme qeverinë, kurse të tri partitë e tjera ishin të opozitës parlamentare. Për rrjedhojë e drejta për të propozuar anëtarin e GNV-ve, u është njohur që me miratimin e normës si partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (sot Partia e Lirisë), ashtu edhe partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

17.3. Nisur nga fakti se në këtë proces zgjedhor zbatimi i dispozitës tranzitore bëhet për herë të dytë, Kolegji Zgjedhor sjell në vëmendje se, një interpretim si më sipër i ligjit, është bërë nga KQZ dhe vetë Kolegji Zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021. Referuar vendimit nr. 8, datë 19.04.2021 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, rezulton se Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet e humbi të drejtën për të propozuar anëtarin e GNV-ve, duke njohur si të tillë vetëm Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim, bazuar në argumentin e KSHZ-së se, pavarësisht se të dyja këto parti kanë fituar më shumë se dy mandate në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, PDIU është pjesëmarrëse në koalicion dhe nuk ka garuar e vetme në zgjedhje, pra nuk ka paraqitur lista kandidatësh. Të drejtat e PDIU-së u vlerësuan të përmbushura nga partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN, në kuadër të të cilit mori pjesë në zgjedhje. Në vijim, edhe KAS mbajti të njëjtin qëndrim, duke theksuar faktin se PDIU në momentin e regjistrimit në koalicion, nuk e mbante më cilësinë e subjektit zgjedhor, gjë që sillte edhe humbjen e së drejtës për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Ky vlerësim përkonte edhe me vetë qëndrimin e LSI-pjesëmarrëse në procesin administrativ dhe atë gjyqësor. Lidhur me këtë çështje Kolegji Zgjedhor, duke gjetur të drejtë vendimin e KAS-it, lidhur me pretendimin e PDIU-së, ndër të tjera arsyeton se: *“...Nëse kjo parti politike do të paraqitej e vetme në zgjedhje, duke paraqitur listën e vet të kandidatëve, atëherë ajo do të gëzonte të plota të gjitha të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor, përfshirë edhe ato sipas neneve 95, 96 e 183(8) të këtij Kodi. PDIU në këtë rast do të paraqitej si subjekt zgjedhor më vete, në kuptim të nenit 63(1) të Kodit Zgjedhor. ...”*.

17.4 Rasti i mësipërm, që referon edhe në mënyrën e zbatimit për herë të parë të nenit 183.8 të Kodit Zgjedhor, konfirmon të drejtën e PDIU-së si një nga partitë e pakicës pas zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2017, për të cilën janë dakordësuar të gjitha subjektet zgjedhore dhe organet e KQZ-së, përfshirë këtu edhe subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim (sot Partia e Lirisë). E drejta e PDIU-së që buron nga neni 183.8 i Kodit Zgjedhor, është konfirmuar indirekt

edhe nga vetë Kolegji Zgjedhor, i cili ka konkluduar në rrëzimin e padisë, bazuar vetëm në faktin se kjo parti nuk garante e vetme, por në një koalicion zgjedhor dhe për këtë, të drejtat e saj ushtroheshin nga partia udhëheqëse e koalicionit.

18. Si përfundim, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se padia e ngritur nga subjekti zgjedhor Partia e Lirisë nuk ka shkaqe të ligjshme për ta mbështetur pretendimin se PDIU nuk e ka të drejtën e propozimit të anëtarit të GNV-ve, sepse referuar rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2017, PDIU përmbush kriterin e fitores të së paku dy mandateve në ato zgjedhje. Pretendimet e palës paditëse, që lidhen me atë se çfarë do të ishte më e ndershme në mënyrën e kompozimit të GNV-ve, nuk përbëjnë çështje të zbatimit të ligjit por mbeten në kuadrin e sugjerimeve për ndryshime të ligjit zgjedhor, çka nuk hyn në kompetencën e gjykatës.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar edhe në nenin 158, pika 1, shkronja “b dhe nenin 159 të Kodit Zgjedhor

VENDOSI

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më datë 12.05.2023.

GJYQTARE

Blerona HASA

(mendim paralel)

GJYQTARE

Alma KOLGJOKA

GJYQTARE

Edlira PETRI

GJYQTARE

Emona MUÇI

GJYQTAR

Sokol IBI